



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 48, dt. 02.04.2015**

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projekt zbatimit për ndërtimin e rrjetit të shërbimeve të telekomunikacioneve në Bashkinë Orikum.
2. Ngarkohet shoqëria “NISATEL” sh.p.k të kontirbuojë në pajisjen me audio guidë për Parkun e Orikumit në bashkëpunim me DRKK-Vlorë.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**